



Federata e Auto Sporteve të Kosovës në mbledhjen e kuvendit të saj të punës të mbajtur më 26.02.2016 nxjerrë,

**RREGULLOREN E AUTO DHE KARTING SPORTIT
TË FEDERATES SË AUTO SPORTEVE
TË KOSOVËS**

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me Rregulloren e auto dhe karting sportit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja), përcaktohen: përkufizimet dhe terminologjia, të drejtat dhe detyrimet elementare të vozitësve, garuesve dhe zyrtarëve sportivë, kushtet themelore për automjete, kushtet themelore për pista në të cilat mbahen garat, bazat e organizimit të garave, sistemi i Kampionatit, kupave, sistemi i mirënjohjeve dhe shpërblimeve të cilat u ndahen vozitësve, garuesve, zyrtarëve sportivë dhe organizatorëve të garave. Çështjet tjera nga fushë veprimtaria e auto dhe karting sportit siç janë: pozita, të drejtat dhe detyrimet e vozitësve, garuesve dhe zyrtarëve të sportit, kushtet të cilat duhet ti përmbushin automjetet dhe pistat të cilat shfrytëzohen në auto dhe karting sport, kushtet shëndetësore për vozitës, përgjegjësia disiplinore dhe materiale e vozitësve, garuesve, zyrtarëve sportiv dhe organizatorit, dhe të ngjashme, rregullohen me Rregullore të veçantë.

Neni 2

Duke pranuar këtë Rregullore, Rregulloret tjera dhe Shtesat, të gjithë vozitësit, garuesit dhe zyrtarët sportivë, janë të detyruar që në mënyrë aktive të punojnë në zhvillimin e auto dhe karting sportit.

Garuesit, vozitësit dhe zyrtarët sportivë marrin pjesë në garat e auto dhe karting sportit me rrezik të vetin personal dhe i nënshtrohen të gjitha llojeve të përgjegjësisë.

ORGANIZATA E AUTO DHE KARTING SPORTIT

Neni 3

Organi sportiv i FASK-ut është këshilli ekzekutiv i FASK-ut.

Neni 4

Këshilli ekzekutiv i FASK-ut themelon Komisionet e veta dhe trupat punues.

PËRKUFIZIMET DHE TERMINOLOGJIA

Neni 5

Përkufizimet dhe shkurtesat e theksuara në nenet në vijim do të përdoren në këtë Rregullore, në Rregulloret e veçanta dhe Shtesat e rregullores dhe paraqesin terminologjinë zyrtare në auto dhe karting sport.

Neni 6

FIA (Federation Internationale de t'Automobile) - Federata Ndërkombëtare e Automobilizmit: është pushteti i vetëm ndërkombëtar sportiv dhe ajo është gjykatë ndërkombëtare e cila në shkallën e fundit është kompetente për zgjidhjen e ankesave në sport të cilat mund të rrjedhin me rastin e aplikimit të rregulloreve të FIA-së.

Neni 7



FASK – Federata e Auto Sporteve të Kosovës, është organizatë jo qeveritare, organizatë jashtë partiake e automobilistëve, vozitësve të kartingut dhe qytetarëve tjerë të cilët vullnetarisht mblidhen në auto dhe karting klube.

Neni 8

AMK/SHAM/AK – Auto-Moto Klubi/Shoqata Auto-Moto /Auto Klubi sportiv, janë format themelore të organizimit të vozitësve, zyrtarëve të sportit dhe qytetarëve tjerë në sistemin e FASK-ut. Këto forma të organizimit mund të kenë edhe thirrje të tjera specifike.

Neni 9

SCI – Komisioni Ndërkombëtar Sportiv.

Neni 10

CIK – Komisioni Ndërkombëtar për Karting.

Neni 11

ASN – Klubi Nacional automobilistik ose lidhja të cilën e pranon FIA si bartësin kryesor të autorizuar dhe kompetent të pushtetit sportiv në një vend.

Neni 12

Dega sportive – Ndarja themelore e aktiviteteve sportive të FASK-ut ne raport me numrit të rrotave dhe karakteristikeve të automjeteve garuese. Degët sportive janë: sportet automobilistike dhe kartingu.

Neni 13

Disiplina sportive – Lloji i disiplinave në auto dhe karting sport në kuadër të degës sportive.

Neni 14

Auto-garat në pistat rrethore – Garat automobilistike në pistat e mbyllura rrethore në të cilat shpejtësia është faktor kryesor për përcaktimin e rezultateve.

Neni 15

Auto-garat në pistat malore – Garat me automobil në pistat malore në të cilat shpejtësia është faktor kryesor për përcaktimin e rezultatit.

Neni 16

Reli – garat në qëndrueshmërinë me shpejtësi mesatare të kufizuara sipas itinerarit dhe programit paraprakisht të caktuar. Në komunikacionin e hapur duhet respektuar të gjitha dispozitat e komunikacionit. Përveç kësaj, mbahen edhe garat e shpejtësisë në pista të mbyllura.

Neni 17

Reli-garat turistike – Garat të cilat organizohen me qëllim të grumbullimit të automobilistëve në vendin paraprakisht të caktuar. Në kuadër të garave të këtij lloji mund të bëhen edhe provimet e llojllojshme ose detyra, duke përjashtuar çfarëdo gare.

Neni 18

Auto-krosi – Garat e automobilistëve të llojeve të ndryshme ne terrenet natyrore në pistat rrethore të mbyllura të cilat nuk lejojnë shpejtësi të mëdha të veçanta.

**Neni 19**

Reli-krosi – Garat e qëndrueshmërisë sipas terrenit të llojllojshëm natyror sipas itinerarit dhe programit paraprakisht të caktuar më parë.

Neni 20

Auto-spidvej – Garat automobilistike në pistën rrethor të pandërprerë me shtresën e lartë të pjerrët.

Neni 21

Auto-sllalomi – Garat automobilistike në pistën me pengesa.

Neni 22

Dragster-garat – Garat në pistën me gjatësi të caktuar në të cilat shpejtësia është faktor kryesor për përcaktimin e rezultatit.

Neni 23

Street race – Garat me automobila në pista të drejta në të cilat shpejtësia është faktor kryesor për përcaktimin e rezultatit.

Neni 24

Drift race – Gara me automobila në pistat rrethore të mbyllura në të cilat këndi i automobilave me rastin e kalimit përmes kthesës dhe shpejtësia janë faktorë kryesor për përcaktimin e rezultatit.

Neni 25

Autobolli – Gara në të cilat dy ekipe të automobilistëve garojnë me top përkatës.

Neni 26

Tuning Styling – Ekspozita e automobilave të modifikuar për gara.

Neni 27

Garat ndërkombëtare – Garat në të cilat kanë të drejtë pjesëmarrjeje vozitësit të shteteve të ndryshme dhe të regjistruar janë në kalendarin ndërkombëtar, si gara ndërkombëtare në kuadër të zonave të caktuara nga ana e FIA dhe CIK.

Neni 28

Shpërblimet e mëdha (Grand Prix) – garat të cilat llogariten për kampionatin botëror ose evropian.

Neni 29

Garat e veçanta – Garat për të cilat garuesit duhet t'i plotësojnë kushtet e veçanta, veçmas gara të kufizuara konsiderohen garat sipas ftesës.

Neni 30

Kampionatet – Seria e garave në bazë të të cilave shpallën kampionët në disiplinë të caktuar.

Neni 31

Gara – Pjesa e evenimentit sportive në të cilën shpejtësia paraqet faktorin vendimtar për përcaktimin e plasmanit.

**Neni 32**

Vozitja – Gara në seri brenda një gare e cila zgjatë një kohë të caktuar ose numër të caktuar rrrathësh.

Neni 33

Garuesit– Pjesëmarrësit në garë AMK/SHAM/AK dhe ekipet e sponsorëve.

Neni 34

Vozitësit – Personat të cilët i drejtojnë automjetet gjatë kohës së garës dhe posedojnë dokumente të nevojshme. Në reli-gara, vozitësi është personi i cili është paraqitur si vozitësi i parë.

Neni 35

Bashkë vozitësit – janë persona të cilët gjenden në automjet ose në mjetin gjatë kohës së garës dhe posedojnë dokumentacionin e nevojshëm. Në reli-gara, bashkë vozitësi është personi i cili është paraqitur si vozitësi i dytë. Dispozitat të cilat kanë të bëjnë me vozitësit aplikohen edhe për bashkë vozitësit.

Neni 36

Fatosët, kadetët, juniorët – Vozitësit kufiri i poshtëm dhe i epërm i moshës rregullohet me shtesën e rregullores për disiplinën përkatëse.

Neni 37

Pista – Lokacioni i përcaktuar në të cilin zhvillohet gara.

Neni 38

Pista e mbyllur – Pista e cila përdoret për garë ose rekorde ku gjatë kohës së garës është ndaluar komunikacioni për automjetet tjera.

Neni 39

Autodromet dhe kartodromet – Pistat veçmas të ndërtuara të mbyllura për mbajtjen e garave.

Neni 40

Vija startuese – Vija fillestare kontrolluese me matje ose pa matje të kohës.

Neni 41

Vija e cakut – Vija përfundimtare kontrolluese me matje ose pa matje të kohës.

Neni 42

Xhiro – Rruga e një rrethi të plotë të pistës, duke filluar prej linjës startuese deri te caku.

Neni 43

Starti – Momenti kurë vozitësi ose numri më i madh i vozitësve të cilët fillojnë së bashku, pasi që të jepet shenja për fillimin e garës ose vozitjes.

Neni 44

Caku – Momenti kurë njërit ose numrit më të madh të vozitësve u është dhënë shenja për përfundimin e garës ose vozitjes.

**Neni 45**

Nisja nga vendi – Momenti kurë automjeti është i palëvizshëm në momentin e dhënies së shenjës për start.

Neni 46

Starti fluturues – Starti tek i cili vozitësi lëvizë në drejtim të vijës startuese dhe vazhdon që të lëvizë duke kaluar përmes vijës startuese pa shpejtësi të kufizuar.

Neni 47

Starti në lëvizje – Starti i automjetit shpejtësia e lëvizjes e të cilit deri të vija startuese kontrollohet.

Neni 48

Licenca – Vërtetimi zyrtar mbi regjistrimin e cila i lëshohet personit fizik i cili drejton automjetin gjatë kohës së garës.

Neni 49

Licenca garuese – Vërtetimi zyrtar mbi regjistrimin e lëshuar personit fizik ose juridik i cili përcakton se në emër kujt vozitësi garon në ndonjë garë (AMK/SHAM/AK dhe ekipit të sponsorit).

Neni 50

Licenca e pistës – Dokumenti zyrtar i cili vërteton se pista e caktuar i përgjigjët kushteve për mbajtjen e garës, në pajtim me dispozitat e Rregullores së veçantë dhe Shtojcës së rregullores për atë disiplinë.

Neni 51

Automjeti – Kjo thirrje shkurtimisht shfrytëzohet dhe ka të bëjë me automjetet motorike.

Neni 52

Kategoritë – Llojet e mjeteve.

Neni 53

Grupi - mjetet e sistemuar sipas rregulloreve përkatëse të FIA dhe CIK.

Neni 54

Klasa – Automjetet e përfshira sipas vëllimit të punës së motorit.

Neni 55

Divizioni – Grupi i automjeteve të cilat së bashku startojnë në garë.

Neni 56

Zyrtari sportivë – Punëtori sportiv me licencë të zyrtarit sportivë të rangut përkatës.

Neni 57

Zyrtari ekzekutiv – Punëtori sportiv i cili e ushtron funksionin e caktuar në garë.

Neni 58

Delegati i garës – Zyrtari sportivë i cili kryen mbikëqyrjen në emër të ndonjë forumi në garën e caktuar.

Neni 59



Organizatori – AMK/SHAM/AK e cila është e autorizuar nga ana FASK-ut që të organizoj garën.

Neni 60

Rregullorja e veçantë – Është akt me të cilin më afër definohen lëmit përkatëse të auto dhe karting sportit të cilat nuk janë të përfshira me këtë Rregullore (përkufizimet për automjete, garues, vozitës, zyrtar sportivë, pista për gara, konditat shëndetësore, përgjegjësitë disiplinore, etj.).

Neni 61

Shtesa e rregullores – Është dokument më të cilin shpallën Kampionatet nacionale dhe kupat me të cilat vërtetohen kushtet, të drejtat dhe detyrimet e të gjithë pjesëmarrësve për një vit, të cilat duhet të jetë në harmoni me këtë Rregullore dhe Rregulloret tjera të veçanta.

Neni 62

Rregullorja e garës – Është dokument zyrtar të cilin e nxjerrë organizatori i garës, me të cilin përcaktohen detajet e asaj gare të cilat nuk janë të përfshira në rregullore, me Rregulloret e veçanta dhe Rregulloren shtesë.

Neni 63

Paraqitja për garë – Forma e marrëveshjes në mes të organizatorit të garës dhe garuesve, me të cilën garuesi, pranon që të merr pjesë në garën për të cilën paraqitet dhe zotohet se do ta respektojë Rregulloren e garës.

Neni 64

Rekord i pistës – Rekordi i cili është vendosur në pistën e caktuar, i shprehur në kohën e harxhuar nga vija startuese deri të caku dhe e arritur në një xhiro ose kalim të pistës e cila është matur nga ana e matësit të kohës në garë.

Neni 65

Rekord i garës – Rekordi i cili është vënë në garat tradicionale në pistën e caktuar, pa marrë parasysh nacionalitetin e garuesit, i shprehur në shpejtësinë mesatare të arritur në tërë garën.

Neni 66

Kundërshtimi – Kërkesa me shkrim me të cilën shprehet mospajtimi me ndonjë veprim ose vendim të organizatorit, Komisionit sportiv, zyrtarit sportiv ose vozitësit dhe kërkohet vendimi i organit kompetent.

Neni 67

Ankesa – Mjeti i rregullt juridik i cili mund ti parashtrohet organit më të lartë të FASK-ut kundër vendimit ose aktit tjetër të organit më të ulët.

Neni 68

Përrjashtimi – Ndalimi i pjesëmarrjes së mëtejme në garën e caktuar ose në më shumë gara të të njëjtit grup.

Neni 69

Suspendimi – Marrja e përkohshme e të drejtave të pjesëmarrjes ose ushtrimit të funksionit në gara deri në marrjen përfundimtare të vendimit.

**Neni 70**

Diskualifikimi – Humbja përfundimtare e të drejtave të pjesëmarrjes dhe ushtrimit të funksionit në çfarëdo cilësie në gara.

Neni 71

Komisioni sportiv – Organi suprem mbikëqyrës në garë.

GARUSIT DHE VOZITËSIT**Neni 72**

Cilësia e garuesit, vozitësit dhe ndihmës-voztësit fitohet me anëtarësim në FASK dhe marrjen e licencës përkatëse të FASK-ut.

Neni 73

Të gjithë vozitësit, përveç vozitësve në karting, duhet të posedojnë patentë shoferin përkatës për drejtimin e automjetit të kategorisë së caktuar.

Me shtesën e rregullores përjashtimisht mund të parashikohen disiplinat e auto sportit ne pistat e mbyllura në të cilat vozitësit mund të marrin pjesë pa patente shofer.

Neni 74

Shoferi më i ri se 18 vjeç, për marrjen e licencës dhe kurë merr pjesë në gara, duhet të posedojë pëlqimin me shkrim të prindërve ose kujdestarëve për tu marrë me disiplinat e caktuara të auto dhe karting sportit. Pëlqimi me shkrim duhet ta përmbaj edhe deklaratën e prindit ose kujdestarit që, në rast të aksidentit në gara, nuk do të kërkoj kompensimin e dëmit nga AMK/SHAM/AK, nga organizatori i garës dhe FASK-u.

Pëlqimi duhet të jetë në formularin e FASK-ut e vërtetuar nga ana e organit kompetent (gjykata, komuna, noteri), në vitin në të cilin vozitësi garon.

Neni 75

Vozitësit të cilët marrin pjesë në auto dhe karting gara sistemohen në rangun përkatës.

Neni 76

Vozitësit të cilët dëshirojnë që ti qasen ndonjë klubi nacional te huaj duhet të posedojnë fletëçregjistrimin e AMK/SHAM/AK amë dhe pëlqimin e Federatës nacionale.

Gjatë kohës derisa të posedojnë licencën e klubit të huaj nacional, vozitësit nuk mund të posedojnë kurrfarë licence të FASK-ut, mirëpo munden, me licencën e klubit të huaj nacional, të marrin pjesë në Kampionat ose Kupë të FASK-ut, nëse janë shtetas të Republikës së Kosovës, me pëlqimin e ASN-së e cila e ka lëshuar licencën.

Neni 77

Shtetasit e huaj të cilët dëshirojnë që ti qasën ndonjë AMK/SHAM/AK duhet të posedojnë vërtetimin e ASN-së të vendit të cilit e kanë shtetësinë, që për atë vit kalendarik nuk janë të regjistruar si vozitës në atë ASN dhe vërtetimin e qëndrimit në Republikën e Kosovës. Vërtetimi i ASN-së mund të përmbaj shënime mbi rangun e licencës të cilën vozitësi i përmendur më herët e ka poseduar. Në bazë të atij vërtetimi ose licence të cilën e bashkëngjisin, i lëshohet licenca e anëtarësimit e njëjtte ose përafërsisht e të njëjtit rang.

**Neni 78**

Shtetasit e huaj te cilët posedojnë licenca te FASK-ut, kanë të drejta, detyrime dhe status të njëjtë, si shtetasit e Republikës Kosovës për kohën derisa zgjatë vlefshmëria e licencës së marrë.

Neni 79

Vozitësit mund të marrin pjesë në gara në botën e jashtme në mënyrë individuale, ekipore dhe në përbërje të reprezentacionit, me pëlqimin paraprak me shkrim të Federatës nacionale. Për pjesëmarrje individuale dhe ekipore në auto dhe karting gara në botën e jashtme, vozitësit dhe ekipet e kërkojnë lejen përmes AKM/SHAM/AK së vetë amë.

Neni 80

Pamja dhe forma e licencës së garuesve, mënyra dhe kushtet e lëshimit të tyre, si dhe regjistrimi i vozitësve dhe garuesve, ndryshimi i AKM/SHAM/AK, mënyra e paraqitjes së garuesve, pajisjet të cilën vozitësit duhet ta posedojnë dhe kushtet shëndetësore të cilat duhet ti përmbushin, si dhe sigurimi të cilin duhet ta kenë, më hollësisht përcaktohet me Rregullore të veçantë mbi të drejtat dhe detyrimet e garuesve dhe vozitësve.

ZYRTARËT SPORTIV**Neni 81**

Cilësia e zyrtarit sportiv arrihet me regjistrimin pranë FASK-ut dhe marrjen e licencës për zyrtar sportiv.

Neni 82

Të gjithë zyrtarët sportiv sistemohen në rangun përkatës profesional dhe në gara ushtrojnë detyrat mbikëqyrëse dhe funksione ekzekutive.

Neni 83

Të gjithë zyrtarët sportiv para marrjes së licencës sportive duhet ta japin provimin përkatës.

Neni 84

Zyrtarët ekzekutiv dhe mbikëqyrës në gara janë të detyruar që së bashku me licencën e zyrtarit sportiv, të bartin edhe shenjën me emërtimin e funksionit të cilin e ushtrojnë.

Neni 85

Zyrtarët sportiv me licenca valide kanë të drejtë në hyrje pa pagesë në të gjitha auto dhe karting garat në territorin e Republikës së Kosovës të organizuara nga anëtarët e FASK-ut.

Neni 86

Regjistrimi i zyrtarëve sportiv, mënyra e lëshimit, kushtet dhe forma e licencës, të drejtat dhe detyrimet e zyrtarëve ekzekutiv dhe mbikëqyrës sportiv, rregullohen me Rregullore të veçantë mbi zyrtarët sportiv.

AUTOMJETËT**Neni 87**

Mjetet me të cilat merret pjesë në gara duhet ti përgjigjen rregullave ndërkombëtare të FIA dhe CIK. Devijimi nga rregulloret ndërkombëtare sportive për automjetet me të cilat merret pjesë në gara për Kampionatin nacional ose Kupë të Kosovës, rregullohet me Shtesat e rregullores mbi auto dhe karting sportin, para fillimit të sezonit të garave.

**Neni 88**

Automjetet me të cilat merret pjesë në garat Reli, duhet ti plotësojnë të gjitha kushtet të cilat kërkojnë dispozitat për automjetet e komunikacionit publik, lejen e vlefshmërisë të qarkullimit ose dokumentet tjera përkatëse dhe policën e sigurimit të pronarit të automjetit nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar personave të tretë.

Neni 89

Automjetet garuese në gara ndahen në kategori, grupe dhe klasa.

Me rastin paraqitjes për gara, vozitësit dhe garuesit, nën përgjegjësin e plotë materiale, me nënshkrimin e fletëparaqitjes, garantojnë se automjeti i tyre i përgjigjet kategorisë, grupit dhe klasës për të cilën e paraqesin dhe i pranojnë të gjitha sanksionet nëse vërtetohet e kundërta.

Të gjitha automjetet garuese duhet që të posedojnë librezën teknike të cilën e lëshon FASK-u.

Neni 90

Para pranimit në garë dhe gjatë garës kryhet kontrollimi teknik i automjetit nga ana e Komisionit teknik të organizatorit dhe atë me metodë vizuale verifikohet se automjeti a i përgjigjet kategorisë, grupit dhe klasës për të cilën është paraqitur dhe kontrollohet rregullsia e pajisjeve të sigurisë.

Neni 91

Verifikimi i automjetit gjatë dhe në përfundimin e garës kryhen në afatet e përcaktuara me rregulloren e veçantë dhe shtesën e rregullores. Së bashku me kërkesë bashkëngjitet depozita në para të gatshme ose tjetër lloj garancioni i mbulesës i të gjitha shpenzimeve të caktuar me Rregulloren shtesë.

Neni 92

Kontrolli i automjeteve pas përfundimit të garës kryhet sipas rregullave dhe dispozitave shtesës së rregullores për disiplinën përkatëse.

Neni 93

Me shtesën e rregullores mund të rregullohet vëllimi dhe lartësia e sigurimit të obligueshëm të automjetit nga përgjegjësia për dëmet e shkaktuara personave të tretë në garat për Kampionatin nacional të Kosovës.

PISTAT**Neni 94**

Të gjitha pistat në të cilat mbahen auto dhe karting garat për Kampionatin nacional të Kosovës, duhet të jenë të sigurta për të gjithë pjesëmarrësit (voztësit, zyrtarët sportiv dhe shikuesit), për çka hartohet Elaborat i veçantë i sigurisë së pistës.

Neni 95

Elaboratin e sigurisë së pistës e bënë organizatori i garës për Kampionatin nacional të Kosovës dhe i njëjti duhet të përmbaj me sa vijon:

1. Skicën e pistës,
2. Përshkrimin e punëve të cilat duhet të kryhen për mbrojtjen e shikuesve, funksionarëve sportiv dhe vozitësve,
3. Vendet në të cilat duhet të vendosën shiritat e tërheqjes së vërejtjes ose rrethojat për shikuesit dhe pengesat mbrojtëse;



4. Vendet për sinjalizim, shërbim shëndetësor dhe shërbim zjarrfikës, si dhe vendet e marshallëve;
5. Shënimi mbi kapacitetin e pistës së garave;
6. Vendet e zonave në të cilat është e ndaluar qasja e shikuesve;
7. Radhitja e policëve dhe kujdestarëve të rendit për siguri;
8. Organizimi i komunikacionit për intervenim të shërbimit shëndetësor dhe evakuimi i personave të lënduar, dhe
9. Zonën servitore dhe parkingun e mbyllur [Parc Ferme].

Neni 96

Elaborati i sigurisë së pistës i dërgohet Komisionit për licencimin e pistave (nëse me shtesën e rregullores për këtë disiplinë është paraparë) dhe dhënia e pëlqimit për të njëjtën (Licenca e pistës), më së largu deri te aprovimi i Rregullores së garës.

Neni 97

Gjatë kohës së kontrollit të pistës, kontrollohet se e njëjta a i plotëson kushtet e parapara me Rregulloren për pista dhe rregulloren e veçantë.

Neni 98

Pas kontrollit të pistës dhe miratimit të Elaboratit të sigurisë së pistës, Komisioni do ta përpiloj procesverbalin me të cilin lejohet mbajtja e garës në pistat përkatëse, kurse FASK-u do ta lëshoj Licencën e pistës. Në procesverbal futën të gjitha punimet e domosdoshme të cilat organizatori duhet ti kryej para mbajtjes së garës për Kampionatin nacional të Kosovës.

Neni 99

Shpenzimet e kontrollit të pistës i bartë organizatori i garës për Kampionatin nacional të Kosovës.

Neni 100

Kushtet më të hollësishme për pistat në të cilat mbahen garat rregullohen me shtesën e rregullores për secilën disiplinë veçmas ose me Rregullore të veçantë mbi pistat për garim.

G A R A T

Neni 101

Garat për Kampionatin nacional të Kosovës mund ti organizojnë klubet, anëtarë të FASK-ut, të cilat disponojnë me objekte të nevojshme sportive ose kanë lejen për mbajtjen e garave në pistën përkatëse, i cili mund të siguroj numër të mjaftueshëm të zyrtarëve sportiv për ekzekutimin e garës dhe kanë të siguruara mjete të nevojshme financiare.

Neni 102

Asnjë garë për Kampionatin nacional të Kosovës nuk mund të mbahet nëse paraprakisht nuk është e regjistruar në kalendarin e garave.

Në garat për Kampionatin nacional të Kosovës, atyre të cilëve ju miratohet Rregullorja e garës nga ana e FASK-ut, në funksionet ekzekutive dhe mbikëqyrëse të garës mund të emërohen vetëm zyrtarët sportiv me licenca të FASK-ut, përveç garave të cilat organizohen jashtë territorit të Republikës të Kosovës, në të cilat mund të emërohen në funksionet ekzekutive zyrtarët sportiv të Federatës nacionale në të cilën mbahet gara.

**Neni 103**

Këshilli ekzekutiv i FASK-ut, duke pasur parasysh kushtet e ofruara nga organizatori dhe elementet tjera të cilat garantojnë kualitetin e organizimit të garës për Kampionatin nacional të Kosovës, vendos se paraqitjet e kujt pranohen dhe cilat gara do të regjistrohen në kalendarin e garave për Kampionatin nacional të Kosovës.

Neni 104

Asnjë garë për Kampionatin nacional të Kosovës nuk mund të mbahet pa Rregulloren e garës e cila rregullon detajet të cilat nuk janë përfshirë me këtë Rregullore, me Rregulloret e veçanta dhe shtesat e rregullores.

Me qëllim të respektimit të dispozitave mbi shfaqjet publike, organizatorët e të gjitha garave, duhet të posedojnë lejet përkatëse nga organet kompetente.

Neni 105

Në Rregulloren e garave, programeve, afisheve dhe të gjitha publikimeve tjera, në vend të dukshëm duhet të vendoset emblema e FASK-ut.

Neni 106

Për të gjitha pa rregullsitë e vërejtura në garë për Kampionatin nacional të Kosovës, të gjithë pjesëmarrësit – bartësit e licencave të FASK-ut (garuesit dhe zyrtarët), mund të paraqesin kundërshtim Komisionit sportiv të garës.

Kundërshtimet paraqitën në formë të shkruar dhe i dorëzohen Drejtorit të garës, në mënyrën dhe në afatet e parapara me Rregulloren mbi organizimit e garave dhe Rregulloren e veçantë për disiplinën përkatëse.

Neni 107

Garat për Kampionatin nacional të Kosovës zhvillohen nën udhëheqjen e Drejtorit dhe të drejtorisë së garave dhe nën mbikëqyrjen e Komisionit sportiv i cili është i vetmi organ kompetent që të vendos për të gjitha kundërshtimet e paraqitura nga ana e garuesve në atë garë.

Neni 108

Organizatori i garës për Kampionatin nacional të Kosovës duhet ta bëjë sigurimin e jetësor të personave zyrtar, funksionarëve sportiv dhe shikuesve në mënyrën dhe shumën e paraparë me Rregulloren shtesë.

Neni 109

Organizatori i garës për Kampionatin nacional të Kosovës duhet të shpallë rezultatet e plasmanëve në afatet dhe me shënimet të cilat rregullohen me Rregullore të veçantë dhe me Rregulloren shtesë.

Rezultatet zyrtare i vërteton kryetari i Komisionit sportiv.

KAMPIONATET DHE KUPAT**Neni 110**

Kampionatet dhe Kupat paraqesin garat sistematike të auto dhe karting sportit, përkatësisht rregullojnë sistemin e garave nga brezi i ri deri te ai masovik, deri te sporti sipëror dhe prezantimi në garat ndërkombëtare. Në Kampionatin nacional të Kosovës mund të marrin pjesë vetëm vozitësit me licenca të lëshuara nga FASK.

Në gara mund të marrin pjesë edhe vozitësit e huaj me licencë të ASN-ve tjetër, me kusht që gara është e regjistruar në kalendarin ndërkombëtar dhe se e kanë pëlqimin e ASN-së amë, mirëpo pa të drejtë



poentimi për Kampionatin nacional të Kosovës. Në rast së gara përkatëse nuk është regjistruar në Kalendarin ndërkombëtar, në ftesën e organizatorit kanë të drejtë pjesëmarrjeje vetëm vozitësit nga shtetet me të cilat FASK ka të nënshkruar marrëveshjen (garat ftuese) me pëlqimin e ASN-së amë për pjesëmarrje në atë garë.

Neni 111

Rregullat themelore të Kampionateve dhe Kupave individuale i rregullon Këshilli ekzekutiv, nën mbikëqyrjen e të cilit edhe mbahen.

Neni 112

Gjatë sezonit garues, nuk janë të lejuara çfarëdo ndryshimesh dhe plotësimesh të shtesave të Rregullores.

Neni 113

Suprimimi dhe ndryshimi i klasave të shpallura dhe grupeve duhet të jetë i paralajmëruar së paku një vit përpara.

Nëse ndonjë klasë ose grup në vitin garues nuk do të jetë i poentuar për shkak të numrit të vogël të automjeteve, do të konsiderohet e anuluar për vitin vijues.

Neni 114

Shtesat e rregullores me të cilat shpallet Kampionati ose Kupa duhet të përmbajnë:

1. Emërtimin, disiplinën dhe vitin në të cilin organizohet;
2. Kalendarin, përkatësisht cilat gara llogariten;
3. Sistemin e poentimit, koeficientin e poentimit të garës dhe numri i garave të cilat llogariten;
4. Mënyrën e përcaktimit të rezultatit përfundimtar;
5. Kushtet e pjesëmarrjes për garues dhe vozitës;
6. Kushtet për automjetet, kategoritë dhe klasat;
7. Numri minimal i automjeteve në klasë, në mënyrë që gara për atë klasë të poentohet;
8. Llojet e sigurimit dhe shumat minimale në të cilat sigurohen zyrtarët sportiv, vozitësit, publiku dhe personat zyrtarë në garë;
9. Shmangia nga normat teknike të FIA dhe CIK në mjete me të cilat marrin pjesë;
10. Lejimi eventual i ndihmës vozitësve gjatë ekzekutimit të trajnimit dhe garës;
11. Përshkrim i detajuar i mënyrës dhe koha e zgjatjes së trajnimit dhe përcaktimi i pozicioneve startuese;
12. Kohëzgjatja e garës dhe vozitjes;
13. Karakteristikat e pistës, lloji, gjatësia, dhe të ngjashme;
14. Sinjalizimi;
15. Mënyra e përpunimit të rezultateve dhe plasmanit në gara, penalizimi dhe të ngjashme;
16. Numri minimal i seancave të Komisionit sportiv dhe orari i tyre i mbajtjes;
17. Shpërblimet, dhe
18. Lartësia e taksave monetare për kundërshtime dhe startime të cilat i paguajnë vozitësit së bashku me paraqitjen.

Neni 115

Në bazë të marrëveshjes të FASK-ut dhe ASN-ve tjetër, garat për Kampionatin nacional të Kosovës mund të organizohen edhe në pistat jashtë territorit të Republikës së Kosovës.



Këshilli ekzekutiv mund të vendosë që ndonjë garë që mbahet jashtë vendit në organizim të ASN-se tjetër të poentohet për Kampionatin nacional të Kosovës, me kusht që gara të jete e regjistruar në kalendarin ndërkombëtar dhe kushtet e përcaktuara me rregulloren shtesë për disiplinën përkatëse.

Neni 116

Këshilli ekzekutiv i cili i miraton Rregulloret e veçanta për mbajtjen e Kampionatit ose Kupës së Kosovës dhe kalendarin e garave, në vend të garës së anuluar, mundë të caktoj garën tjetër, mirëpo vendimi i tillë duhet të merret më së largu para mbajtjes së dy garave të fundit për Kampionatin nacional të Kosovës.

Neni 117

Nëse numri i garave të poentuara është më e vogël se 4 (katër), nga cilido shkak, do të konsiderohet se Kampionati nacional i Kosovës ose Kupa nuk është mbajtur.

MIRËNJOHJET

Neni 118

Për rezultatet e arritura sportive dhe sukseset e vozitësve, garuesve, organizatorëve të garave dhe zyrtarëve sportiv, ndahen mirënjohjet.

Neni 119

Për rezultatet e arritura në fund të vitit, u ndahen këto mirënjohje vozitësve, ekipeve dhe organizatorëve:

- Medalje,
- Plaketa;
- Diploma, dhe
- Mirënjohje.

Neni 120

Medaljet u ndahen për vendin e parë, të dytë dhe të tretë vozitësve dhe bashkë-voztësve, në secilën klasë të shpallur, grup dhe plasman të përgjithshëm.

Në medalje shkruhet emri dhe mbiemri i vozitësit dhe bashkë-voztësit, emërtimi i disiplinës, vendi i zënë, klasa dhe viti, kurse për ekipe emri, emërtimi i disiplinës, vendi i zënë dhe viti.

Neni 121

Diplomat u ndahen vozitësve dhe bashkë-voztësve për vendin e zënë të parë, të dytë dhe të tretë në secilën klasë të shpallur dhe plasmanin e përgjithshëm, si dhe ekipeve për vendin e zënë.

Në diplomë shkruhet emri dhe mbiemri i vozitësit ose bashkë-voztësit, emërtimi i disiplinës, vendi i zënë, klasa dhe viti në të cilin Kampionati është mbajtur, kurse ekipeve për vendin e zënë, emërtimi i disiplinës, vendi i zënë dhe viti në të cilin është mbajtur Kampionati.

Diplomën e nënshkruan Kryetari i FASK-ut.

Neni 122

Plaketat ndahen ekipeve për zënien e vendit të parë, të dytë dhe të tretë.

Neni 123



Helmeta e artë i ndahet vozitësit i cili tre herë me radhë (një pas një), përkatësisht gjithsej pesë herë e ka fituar Kampionatin nacional të Kosovës në të njëjtën disiplinë. Nëse vozitësi gjatë një viti garues ka fituar disa herë titullin e kampionit, për ndarje të helmetës së artë llogaritet vetëm një titull nga ai vit. Plaketa e artë i ndahet ekipit i cili tre herë radhazi (një pas një), përkatësisht pesë herë e ka zënë vendin e parë në konkurrencën e ekipeve në të njëjtën disiplinë.

Neni 124

Helmeta e artë me diamant është trofeu më i madh i cili i ndahet vozitësit i cili tre herë e ka fituar helmetën e artë.

Neni 125

Për popullarizimin e auto dhe karting sportit, u ndahen shpërblime dhe mirënjohje gazetarëve, përkatësisht organizatave të informimit publik, të cilët gjatë vitit më së shumti i kanë kontribuar zhvillimit dhe informimit për auto dhe karting sportit.

Për kontribut të veçantë në zhvillimin e auto dhe karting sportit, u ndahen mirënjohje sponsorëve dhe zyrtarëve të sportit me propozim të Këshillit ekzekutiv.

Zgjedhja e sponsorit dhe zyrtarëve sportiv, bëhet me propozim të Këshillit ekzekutiv.

Neni 126

Për rezultate të veçanta të arritura në organizimin e garave, në fund të vitit do të ndahet organizatorëve më të mirë të garave për Kampionatin nacional të Kosovës mirënjohje, në të gjitha disiplinat.

Neni 127

Vendimin për mirënjohjet e merr Këshilli drejtues i FASK-ut, dhe i nënshkruan Kryetari i FASK-ut. Mirënjohjet dhe shpërblimet ndahen në shpalljen solemne të rezultateve në fund të zezonës garuese.

PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE DHE MATERIALE

Neni 128

Garuesit, vozitësit, zyrtarët sportiv dhe organizatorët e garave për Kampionatin nacional të Kosovës, duke u marr në mënyra të ndryshme me auto dhe karting sportin, e pranojnë këtë Rregullore dhe detyrohen që me vetëdije dhe me përgjegjësi të plotë t'i kryejnë detyrat dhe obligimet e veta, me qëllim të ruajtjes së prestigjit të auto dhe karting sportit dhe të FASK-ut.

Neni 129

Të gjithë shkelësit e kësaj Rregulloreje, Rregulloreve të veçanta dhe Shtesave të Rregulloreve me të cilat rregullohen garat për Kampionatin nacional të Kosovës, ose ata të cilët në çfarëdo mënyre me veprimet dhe sjelljet e veta i shkaktajnë dëm auto dhe karting sportit, i nënshtrohen përgjegjësisë disiplinore.

Neni 130

Masat disiplinore janë si vijon:

1. Vërejtje,
2. Dënimi me gjobë;
3. Ndalimi i organizimit ose pjesëmarrjes dhe ushtrimi i funksionit në të gjitha ose garave të caktuara në periudhën e caktuar kohorë;
4. Ndalesa e përjetshme e pjesëmarrjes dhe ushtrimit të funksionit në të gjitha garat – diskualifikimi dhe
5. Shlyerja nga plasmani dhe marrja e poenëve të fituar.



Ekzekutimi i ndonjë mase disiplinore mund të pezullohet ose anulohet dhe kushtëzuar në mënyrën e përcaktuar me Rregullore të veçantë për përgjegjësinë disiplinore.

Neni 131

Masat disiplinore i shqiptojnë Organet disiplinore të cilat i emëron Këshilli ekzekutiv, në procedurë dhe mënyrë të rregulluar me Rregullore të veçantë për përgjegjësinë disiplinore.

Neni 132

Mënyra dhe afatet e parashtrimit të kërkesave për iniciimin e procedurës disiplinore, personat e autorizuar për parashtrimin e kërkesave, mënyra e udhëheqjes së procedurës dhe vendosja, si dhe shqiptimi i masave disiplinore, do të caktohen me Rregullore të veçantë për përgjegjësinë disiplinore.

ANKESAT DHE KËRKESAT E JASHTËZAKONSHME

Neni 133

Kundër vendimit të Komisionit sportiv të garave dhe konstatimit të Komisarit teknik, pjesëmarrësit e garave për Kampionatin nacional të Kosovës mund ta parashtrojnë ankesë.

Ankesa në vendimin e Komisionit sportiv të garave i parashtrohet Këshillit ekzekutiv. Ankesat në gjetjet e komisarit teknik i parashtrohen Komisionit Teknik.

Ankesat në vendimin e Komisionit sportiv të garave, Komisionarit teknik dhe vendimeve tjera të personave kompetent në gara parashtrohen në afatin e paraparë me Rregullore të veçantë mbi organizimin e garave.

Neni 134

Në vendimin e formës së prerë të organit të shkallës së dytë Disiplinor nuk mund të parashtrohet ankesë.

Pala e pa kënaqur mund të parashtrojë kërkesë për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit Këshillit ekzekutiv në afat të definuar me Rregullore të veçantë mbi përgjegjësinë disiplinore.

Neni 135

Në të gjitha procedurat e vendosjes, për situatat të cilat sipas kësaj Rregulloreje dhe Rregulloret tjera të veçanta, nuk janë rregulluar veçmas, do të aplikohet rregullativa juridike e rregullave ndërkombëtare të FIA-së.

DISPOZITAT E FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 136

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen sipas të njëjtës procedurë e cila vlen edhe për nxjerrjen e saj, nga ana e Këshillit drejtues të FASK-ut.


Të drejtën e shpjegimit të dispozitave të kësaj Rregulloreje e ka Këshilli drejtues i FASK-ut.

Neni 137

Kjo Rregullore hynë në fuqi me ditën e nxjerrjes të së njëjtës, kurse pushon të vlen Rregullorja paraprake Gjenerale për Auto Sporte të FASK-ut.

FEDERATA E AUTO SPORTEVE TE KOSOVES




Ismet Rexhepi, kryetar - FASK-ut